REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 1134/20
Datë/Datum. 11.01.21
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Avdush Bajramaliu, *Eksperti shqyrtues i jashtëm*	*30.12.2020*	*09.01.2021*	**Nr. i lëndës:** **1134/20**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 23.12.2020, K.N.T.SH."TEUTA-M"SH.P.K., ka parashtruar ankesë me nr: **1134/20**, kundër Njoftimit për Kontratë autoritetit kontraktues, **Komp. Rajon Ujësjellësit"Hidromorava" SH.A.** ,lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Sanimi,menaxhimi dhe mirëmbajtja e sistemit te ujësjellësit në Lagjen Qameria, Kamenicë"** me nr. të prokurimit: **20-7882-5-2-1**me nr.te brendshme **KRU-2020-008-521**iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komp. Rajon Ujësjellësit"Hidromorava" SH.A**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedur e hapur**, lloji i kontratës: **PUNË** vlera e parashikuar e kontratës: **30,000.00 €**

SHENIM: (Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP-së)

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues..

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE te OE.Ankues

Njoftimi për kontrate: 27.11.2020
Afati për dorëzimin e ofertës : 07.12.2020 ora 14:00
Njoftimi mbi Vendimin e AK-se 08.12.2020
Kërkesa për Rishqyrtim 14.12.2020
Përgjigjja ne kërkesën për rishqyrtim 14.12.2020
Ankesa ne OSHP.23.12.2020

Pretendimet ankimore te OE,Ankues "K.N.T.SH."TEUTA-M"SH.P.K":

1. **Neni 1. Qëllimi i Ligjit.**
2. **Neni 7. i LPP-se**
3. **Neni56.3 i LPP-së**
4. **Neni 60 i LPP-së**
5. **Neni 87Paragrafi 2 i LPP-së**
6. **Neni 41.3i RRUOPP.**
7. **Neni 18.1 -18.2 i RRUOPP-së**

Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet e OE-se ankuese

Me date 08.12.2020 kemi pranuar Njoftimin mbi Vendin e AK-se për procedurën ne fjale si dhe Njoftimin mbi eliminimin .
Ne menjëherë po te njëjtën date kemi dërguar emailin me kërkesë për lejim ne qasje ne dokumentacion ,ku AK-ja po te njëjtën date na ka kthyer përgjigjeje mbi lejimin e qasjes ne dokumentacion me date 09.12.2020 prej ores9:00 h.
Gjate qasjes ne dokuinnentacion te OE te shpallur fitues ne prezencë te menaxherit te prokurimit kemi hasur ne këto lëshime te procedurave te tenderit si dhe mungesë te dokumentacionit te OE ENGROUP
Gjate qasjes në dokumente kemi vërejtur se OE i shpallur fitues nuk i ka dëshmitë për përmbushje të kërkesave t e pranueshmërisë t e cilat kane te bëjnë me Vërtetimin nga ATKqe nuk ka borxhe dhe Certifikatën e gjendjes ekonomike Menaxheri i prokurimit i pranon se nuk ja ka kërkuar fare para shpalljes se njoftimit OE fitues

Qysh ne fillim shihet se nuk janë përfill ligjet dhe procedurat e këtij tenderi ,nuk kane shkuar sipas ligjeve te KRPP-se.
Ne ua rikujtojmë ecurinë e procedurave te një tenderi pas pas vlerësimi te tij nga komisioni i vlerismit Konform nenit 87, paragrafit 2, nënparagrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për ProkuriniinPublik, i ndryshuar dhe plotësuarme Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr.03/L-099,KRPP sqaron si në vijim:

1. Komisioni *i* vlerësimit përfundon vlerësimin e *ofertave'dhe e* rekomandon operatorin Ekonomik për dhënie të kontratës
2. Kekohen nga OE i rekomanduar për kontratë dëshmitë për përmbushje të kërkesave të pranueshmirisë të specifikuara në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë
3 Pas pranimit të dëshmive të pranueshmerisë, Zyrtari përgjegjës i Prokurimit e nënshkruan raportin e vlerësimit dhe raporti ngarkohet në platformën e prokuriinit elektronik
4 Kërkohet nga ZKA dhe ZKF rikonfirmimi i Deklaratës se Nevojave dhe Disponueshmërisë se mjeteve
5 Përgatiten dhe dërgohen përmes platforrnës elektronike dhe përmes-emailave letrat standarde tek OE që kanë dorëzuar tender dhe në të njëjtën ditë përgatitet dhe ngritët si"dokument shtesë'në platformën e prokurimit elektronik FS. B58"Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues"
6 Periudha e pritjes –pritet 5 dite për kërkesë për rishqyrtim (dita e dërgimit është dita 0)
7 Nëse nuk ka kërkesë për rishqyrtim përgatitet dhe dërgohet ne platformë elektronike **Njoftimi për dhënie te kontratës /Njoftimi për anulimin e aktivitetit te prokurimit.**
8 Pas publikimit te njoftimit për dhënie te kontratës AK,nënshkruar kontratën
9 Brenda dy ditëve pas nënshkrimit te kontratës ,AK dërgon për publikim FS. B52 **Njoftim për nënshkrim te kontratës**
10 Nëse ka kërkesa për rishqyrtim ZP publikon **Njoftim për pezullim,shqyrton kërkesën,nxjerr vendimin dhe te njëjtën e publikon ne platformën elektronike.**

Nëse kërkesa miratohet ZP do te vazhdoj me ri-vlerësim aktivitetit te prokurimit duke filluar nga hapi 1.
Nëse kërkesa refuzohet . ZP *do te pres* 10 dite për ankesa, dhe nëse nuk ka ankesa vazhdon nga hapi 6
Nëse kërkesa refuzohet,ZP pret 10 dite për ankesa dhe nëse ka ankesa vepron ne përputhje me vendimin e OSHP-se
Konform nenit 87. paragrafit 2, nen paragrafi it 2.8 te Ligjit Nr. 04/L.-042 për prokurimin publik i ndryshuar dhe plotsuarme ligji Nr.04/L-237,Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-099

Nese OE i rekomanduar për kontrate dështon qe brenda afatit ti sjell dështmitë atëherë ai OE eliminohet.

Shpjegohet shume te mire qe pasi te behet vlerësimi i tenderit.japi i dyte menjëherë dhe esencial është kërkimi nga OE.I rekomanduar për kontrate te dorëzoj kërkesat e pershtateshmeris,e qe ne këtë rast janë Vërtetimi i ATK-se dhe Certifikata nga Gjykata Ekonomike
Këtë hape AK-nuk e ka bere dhe qysh ne fillim ka bere shkelje te ligjeve te KRPP-se
Tek letra e eliminimit për kompaninë tone AK-ja ka cekur mungesë te dy dokumenteve nga ana jone
Gjate qasjes ne dokumentacionin AK-ja vet e ka pranuar qe për njërin dokument i cekur nga AK-ja ne letrën e eliminimit ,i ka mbetur kopje nga një tender tjetër d.m.th. nuk ka te bej me këtë tender fare dhe është lëshim nga ana e AK-se.

Kurse për arsyet e tjera te eliminimit nga AK-ja per kompaninë tone te cilën e ka cekur ne njoftimin për eliminim :**Ne Nuk kemi ofruar liste mbi spefikicimin e çmimit dhe as deklarate ku konfirmojnë se gjitha *materialet janë* konform aneksit *1*.**

Edhe gjate qasjes ne dokumentacion ne ja konfirmuam dhe vërtetuam qe kjo nuk ka qene fare kërkesë nga ju ne dosje te tenderit.

Gjithashtu dëshirojmë te ja dëshmojë edhe një herë me shkrim dhe me fakte ne ketë ankese se nuk ka qene kërkese dosje te tenderit si dhe keni bere shkelje bazike te ligjve te KRPP-ës.

Për me tepër ju lutem shikoni mire Dosjen e Tenderit dhe Kërkesat qe janë ne DT.
Kjo kërkesë nuk ka qene fare e futur nga AK-ja dhe menaxheri i prokurimit tek Kërkesat e Dosjes se Tenderit dhe as tek njoftimi për kontrate. Gjegjësisht nuk ka qene e futur fare tek FDT - Fleta e te Dhenave te tenderit ku ne këtë pjese gjithmonë dhe sipas ligjeve shkruhen **Kërkesat Obligative te Dosjes se Tenderit.**

Sipas Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimit Publik përgatitja e një dosjet tender zyrtari përgjegjës i prokurimit përveq tjerave përbehet nga këto pjese:

Pjesa A, procedurat e tenderimit ,përbehet nga dy pjesë:
-udhezime per ofertuesit
Fleta e te dhënave të tenderit dhe anekset
Udhëzimi për ofertuesit është një formë standarde që nuk ka nevojë të plotësohet nga AK Zyrtari i prokurimit duhet të plotësoj fleten e te dhënave te tenderit për secilin aktivitet të prokurimit.

Shih Rregullat dhe udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik faqe 26 dhe 27

Siç shihet dhe është dashur të dihet nga AK-ja, qe gjitha kërkesat për një Dosje te tenderit duhet tëshkruhenteFDT Fleta e te dhenave te tenderit.

AK-ja një kërkese të tille *per* një Deklaratë ku konfirmohet qe materialet janë sipas aneksit l , apo kërkesë mbi Specifikimet e materialeve nuk e ka kërkuar fare, dhe rrjedhimisht ka berë shkelje te Nenit 41.3 sipas rregullatorit dhe udhiëzuesit operativ per prokurimpublik.ku sipas Parimeve kryesore te procedures se vlersimit sipas LPP-se nder te tjera eshte pika nr.4 ku thuhet Tenderët *e* pergjegjshem do *te* vlersohen ne baz te kritereve te specifikuara te dhënies se kontrates dhe
Pika nr.5 ku thuhet.Vetem kërkesat dhe kriteret e dhënies se kontratës te specifikuara ne njoftimin per kontrate mund teperdoren si baze per vlerësim.
Shih Rregullat dhe Udhëzuesi Operative *per* Prokurim *Publik faqe 92*

AK-ja ka marr për baze për vlerësim një kriter qe nuk e ka kërkuar fare

Duke pasur parasysh faktet qe u ceken me lart kuptohet qe AK-ja na ka elminumuar për një kërkesë e cila nuk ka qene ne FDT,prandaj keni vepruar ne kundërshtim me nenin 56.3 te LPP-se sepse aty çart shkruan *"Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.*

Gjithashtu ne dishirojm te ju dëshmoj rastet kur vet AK-ja Kërkesën e tille ka bere sipas ligjeve te KRPP-Së gjegjesisht tek fleta e te Dhënave te tenderit.

Tenderi nr. nuk ka-18-9448-3-2-1 KRU-2018-014-321 Titulli:Ndërrimi I gypave te ujësjellësit për Gjilan, Viti dhe Kamenicë, Loto 1. Ndërrimi i gypave te kanalizimit, për Gjilan, Viti dheKameniceLoto2.
AK-ja vet tek FDT Fleta e Te Dhënave te tenderit te Kriteret ka kërkuar Certifikatat Materialeve :Një deklaratë me shkrim nga OE për atestimin e pjesëve ujësjellësit gypave te ujit pjesëve tjera. Ku edhe i ka cekur gjitha Standardet dhe specifikacionet qe duhet te plotësohen.
Gjithashtu edhe tek procedurat e AK-së e tenderit Nr.KRU-20-005-246 me titull: Vendosja e sistemit Alarmues dhe mirëmbajtja e tyre dhe vendosja e Kamerave.
*Tek k*ërkesat FTD ka kërkuar nga OE te dorëzoj katalogë apo broshura për gjitha pajisjet e ofertuar.OE duhet te dorëzoj listën e produkteve te ofertuara. OE duhet te dorëzoj një deklarate me shkrim mbi garancionet.
Sipas procedurave te tenderit ,nëse kërkohet nga AK-ja qe OE ti plotësoj kushtet sipas Specifikacionit Teknike te Aneksit1,kjo kërkes behet tek FDT ku kërkohet p.sh qe OE te dorëzoj nje deklarate qe i plotson kushtet sipas specifikacionit teknik te aneksit 1. Kurse tek aneksi l shkruhen cilat specifika jan ato, gjegjsisht qfar standarde kerkohen për ato materiale te kërkuar.AK-ja këte nuk e ka bere , dhe rrjedhimishtkjo nuk ka qene Kërkesë fare ne Dosjen e tenderit për këtë procedurë
<u>Gjate qasjes jes ne dokumentacionte OE Engoup te shpallur fitues ne kemi gjetur këto te gjetura apo mangesi:</u>
Kerkesa ne DT:OE duhet te ofroje deshmi se ka perfunduar me sukses projekte te natyres se kesaj kontrate gjate tre viteve te fundit (2017-2018-2019)
Dëshmi listen e kontratave te bashktangjitur me referenca minimum 45,000.00 €

E gjetur . OE Engroup ka dorëzuar listën e kontratave prej vitit 2014 deri 2017 Nuk e
përmbush kriterin bazik te listës se kontratave.
Gjithashtu gjitha referencat qe ika edhe pse janë shume te vjetra. d.m.th. me te vjetra se 3 vitet e fundit,kan tt e bëjnë me Riparime objekteve dhe ndërtirn i larte (ndërtim I sallave,ndërtim i qendrave,anekseve etj) dhe asnjë,asnjë kontrat e vetime ne Ujësjellësit apo kanalizimeve veqanërisht te natyrës se këtij tenderi qe ka te beje me ndertim te ujsjellësit
Ne nuk e dijmë se cilën kontrate apo reference e ka mare për baze kornisioni i vlerësimit te ofertave apo menaxheri i prokurimit kur e ka shpallur fitues për këtë procedurë.
Te vetmen reterence te dorëzuar brenda afatit kohore brenda tri viteve e ka te dorëzuar ne vitin 2018 vlere prej 42.819.57 € e cila ka titullin Riparimi i objekteve te bashkësisë lokalee lëshuat nga KK Prishtine. Përveq qe është nen vlerën minimale te kërkuar prej 45,000.00 € kjo reference nuk ka *te* beje fare me lemin e ujsjellësit.
<u>Kërkesa ne DT: Listën e pagave se paku 5 punëtor nga ATK-ja</u>

OE Engroup ka dorëzuar Listën e pagave për 5 persona nga ATK, ku pas qasjes ne dokumentacionin është vërejtur dhe vërtetuar se këta 5persona janë te paraqitur vetëm deri ne muajin e 6 te këtij viti, qe do te thotë prej muajit 7 deri me tani nuk ka punëtor te paraqitur fare ne ATK. Andaj nuk mund te merret për baze, pasi qe është kërkuar lista nga ATK, e qe do te thotë deri ne muajin e fundit paraprak.
Gjithashtu ne këtë listë është i futur dhe Nuhi Nuhiu ing. ndërtimtarisë, i cili ne vendim te kësaj kompani është

caktuar Menaxher i Projektit për këtë tender-projekt,qe do te thotë nuk e përmbush kushtin *qe* ti kete se paktu 5 punëtorë,*pasi* dalin *te* jen 4 dhe si i tillë nuk e plotëson këtë kriter.
Kërkesa për lngjinierët ka qene e veçanta, kurse kërkesa për 5 punëtor ne ATK ka qen e veçante po ashtu edhe kërkesa për 2 punëtor te certifikuar për saldim te gypave PE ka qene e veçantë.

Kërkesa DT: Ing.i Diplomuar I Gjeodezisë.
: OE i shpallur fitues ka dorëzuai- Bacelor Gjeodezis dhe një vendim për "Master ofScience"(master i shkencave) *por* i mungon Diploma mbi këtë grade dire nuk qartësohet *se i çfarë* shkencave
Kërkesa DT: Inxhinierët *e* kërkuar *te jenë* ne listën e *të* punësuarave *ose te këtë* marrëveshje bashkëpunimi për këtë Projekt.
OE Engroup nuk ka dorëzuar Vendim mbi caktimin e detyrave për stafin Professional për secilin veç e veq *per* ketë tender, ku vetëin *per* Ing. Ndërtimtarisë ka dorëzuar kurse për Ing.Hdros dhe ing.e Gjeodezisë nuk ka dorëzuar.
Gjithashtu ka dorëzuar nga një kontrate bashkëpunimi për këtë tender për gjithë stafin e paraqitur,ku te njëjtën kontrate për secilin antar apo inxhinier e ka te njëjtë te caktua rme pozite:sieksperte e Hidroteknikes.D.m.th.kontratën e njëjtë për gjithë stafin,sikur për ing.ndertimtaris,ing.gjeodezis, ing. Hidroteknikes, 2 punëtoret saldimite ka te njëjtë me detyrë te caktuar ne kontrate:si eksperte e Hidroteknikes.
Kurse ne kerkesat e DT nuk është kërkuar"Eksperte e Hidrotelcnikes''mirepo qarte kërkohen ingjinierët dhe salduesit.
Per punëtoret esaldimin. nuk janë certifikatat apo diploinat e noterizuara dhe rnungojnë CV ku deshmohet përvoja.
"Tek kërkesa e kapaciteti teknik dhe professional është kërkuar.
Kërkesa2Makinësaldimi,standard për gypa PE.
Dëshm
i2,Dokument mbi posedimin apo pronësinë e makinës se saldimit për gypa PE
D.m.th. eshtë kërkuar qe OE ti kete ne pronesi apo posedim Makineritë e saldim dhe jo me marrëveshje për shfrytëzim.OE Engrup ka dorëzuar marrëveshje për shfrytëzim me Hidroprojekt,te kësaj makinerie pasi nuk e ka ne pronësi siq eshte kërkuar.

Gjithashtu insistimi AK-si per eliminimin e kompanise son pse nuk kemi dorëzuar specifikim-liste te furnizimeve. edhe po te ishte si kerkesë e paraqitur ne FDT nuk qendron fare.Pasi kjo eshte nje kontrate për krverjen e punëve shërbimeve dhe jo furnizim.
Gjithashtu edhe OE Engroup nuk ka dorëzuar asnjë listë te furnzomevete materialitsiç pretendon AK-ja,por vetem nje deklaratë qe eshte deklarate standard se materialet jane sipoas specifikacionet te aneksi 1

Edhe po te ishte kërkesa e AK-se legjitime si e till. OE Engroup nuk e plotëson pasi nuk ka doreyuar fare pasi si pas Rregullat dhe Udhëzucsi opperativ për Prokurim Publik faqe 88 mjfte mire e shpjegon kur mund te mirret parasysh Deklarata e tille. Përveç ne raste kur OE nuk mund te dorëzoj specifkim teknik te nje produkti te caktuar p.sh peme/perime etj. mund te mirret si emirfillt si Deklarat
OE Engroup nuk ka dorëzuar specifikim fare te asnje produkti e lere me te nje produkti te caktuar apo materiali,kurse deklarata mund te mirret për baze kur I dorëzon disa specifikime mirëpo jo te gjitha.ateher rnund te mirret për baze. Kurse OE Engroup nuk ka dorëzuar fare asnjë listë te materialeve apo specifikimeve.
Ne me dt.14.12.2020 kemi marrë përgjigje ne kerkesën për rishqyrtim ku auttoriteti kontraktues ka deklaruar se refuzohet kërkesa për rishqitim,mirëpo nuk ka dhënë asnjë përgjiigje konkrete dhe ligjore në pretendimet tona ankimore
Duhet te ceket qe edhe ketu AK nuk i permbahet rregullave te Prokurimit Pub1ik.pasi qe lenden e njejt nuk e pezullon fare deri ne vendimin mbi kerkesen tone, mirepo direkt dergon leter pergjigje mbi kerkesen tone per riqshyrtim ku nuk mirret fare me pikat tona ankimore,mirepo thote qe AK dote vazhdoj *me* procedura pasi qe vendimi i tyre eshte ne

rregull.. Shih pergjigjëjen e bashkangjitur ne dokumentacion

Sa i përket arsyeve të AK-së për refuzimin kërkesës tonë për rishqyrtim, ju sqarojmë se nuk qëndrojnë për faktin se nëse AK-ja nuk ka ofruar asnjë dëshmi konkrete, që tregon se pretendimet tona ankimore janë të pabazuara.
Andaj përderisa nuk është ofruar asnjë dëshmi konkrete pretendimet tona ankimore janë te bazuara dhe qëndrojnë,gjithashtu është për tu habitur fakti se si AK-ja në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim e ka cekur se nuk ka nevoje të bëhet rishqyrtimi i vlerësimit të ofertave,përderisa OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm
Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet qe u ceken më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie te kontratës, e që ka qen tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulet sipas neni 60 paragrafi1.1iLPP-se.
Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 te LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik. edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe te njoftimit për kontratë, nuk jemi shpallur fitues te këtij tenderi
Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar edhe dispozitat e nenit 1 të LPP-së,pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji eshtë të siguroj në mënyrën më efikase me transparente dhe me te drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike,burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve te autoriteteve tjera ne Kosovës
Duke pasur parasysh te gjitha arsyet faktike dhe ligjore që u përmendën më lartë kërkoj nga OSHP që të merr:

VENDIM
APROVOHET si e bazuar ankesa e OE."TEUTA-M shpk.
ANULOHET ,Njoftimi mbi vendimin e AK-se për dhënie te kontratës dhe lënda kthehet ne RIVLERSIM
DETYROHET autoriteti kontraktues qe gjate rivlerësimit ,ekzaminimit dhe krahasimi i ofertave te behet ne harmoni me kërkesat e dosje se tenderit,njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave te LPP-se
Nëse nuk merren parasysh faktet tona ,ne jemi te detyruar te vazhdojmë procedurat ligjore ne institucionet tjera kompetente.

Demet materiale

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e *ofertes,* në vlerë prej 5,000.00 euro.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesa	**Dëshmia**
Vërtetim nga Administrata tatimore e vendit tuaj te themelimit se nuk jeni ne vonese për pagimin e tatimeve se paku deri ne tre mujorin e fundit përpara datës se dorëzimit te tenderit-Per kompanin fituse te tenderit 3. Dokument apo vertetim që nuk ka konteste gjyqësore ne Gjykatën Ekonomike	**Vërtetimi nga Administrata Tatimore ,për OE të rekomanduar për kontratë,para dhënies së kontratës. Origjinali Evidenca Evidenca 3, Vërtetim apo dokument nga Gjykata ekonomike qe nuk është ne falimentim apo ne kontest gjyqsore. (nga gjyk.ekonomike)**
Kërkesa **Lista e stafit ku janë të përfshirë stafi i kërkuar në pikën 2 dhe më gjere,bashkangjitur edhe CV, diplomat e notorizuar (për Inxhinieret), dëshmi mbi përvojën e punës, si dhe kontratat e punës** **Listën e pagave se paku 5 punëtore (nga ATk-ja**	**Dëshmia** **Deshmia-2. Dëshminë ,Lista e stafit ku janë të përfshirë stafi i kërkuar në pikën 2 dhe më gjere,bashkangjitur edhe CV, diplomat e noterizuar (per Inxhinieret), dëshmi mbi përvojën e punës, si dhe kontratat e punës ose të bashkëpunimit për këtë projekt (për te gjithë Inxhinieret ,ku dëshmohet se paguajnë tatimet**

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:
Komisioni i vlerësimit bazuar ne vlerësimin e bere ofertave ,kontrollet e ofertave ,konkludon se kemi një oferte te përgjegjshëm ne vlere prej 29.738,63 euro
Dhe duke u bazuar ne vlerësimin e ofertave sugjeron Zyrtarin Prokurimit qe me kontrate te shpërble O.E " ENGRUP"shpk
(Të përshkruhet vetëm vlërësimi i ofertësë OE ankues /ofertave, por të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

- N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES: K.N.T.SH."TEUTA-M"SH.P.K

Përgjigje ne pretendimet ankimore te OE-së ankues

Përgjigje ne Pretendimin ankimore se lidhur me dëshmit për kërkesat e pershtatshmeris

*Lidhure me këtë eksperti shqyrtues ka vërejtët se AK-ka shpallur fituesin pa i kërkuar dëshmitë për përmbushjen e kërkesave te përshtatshmërisë,(**Vërtetimi nga Administrata Tatimore ,për OE të rekomanduar për kontratë,para dhënies së kontratës. Origjinali Evidenca Evidenca 2., Vërtetim apo dokument nga Gjykata ekonomike qe nuk është ne falimentim apo ne kontest gjyqësore. nga gjyk.ekonomike)***
AK, Njoftimin mbi vendimin e saj dhe letrat standarde i ka perciellur me dt.08.12.2020,kurse këto dëshmi te përshtatshmërisë janë te ngarkuar nga OE.i Rekomanduar për kontratë ne platformë me dt.30.12.2020 ,ku me këtë date AK.e ka përcjell për publikim Njoftimin për dhënie te kontratës.
Pra pretendimi ankimor për këtë pike qëndron sepse AK-ja para Njoftimit për vendim te saj dhe para letrave standarde është dashur te i'a kërkon Dokumentet e përshtatshmërisë (Vërtetimi i ATK-se dhe vërtetimi i Gjykatës) OE,te rekomanduar e pas dorëzimin te tyre te shpallet si fitues (Njoftim për Vendimin e AK-se dhe Letrat standarde)

Përgjigjeje ne Pretendimi ankimor mbi listën për specifikimin e çmimit dhe deklarate konfirmimi se mater.jane

konform aneksit 1

Lidhur me këtë pretendimi ankimor eksperti shqyrtues gjate shikimit te dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontrate nuk ka vërejtur se është përcaktuar si kriter vlerësimi qe OE.te dorëzon liste mbi specifikimin e çmimit dhe as deklarate se kërkohet konfirmon se te gjitha materialet janë konform aneksit 1 te dosje te FDT-ja.
AK-ne letrën standarde për eliminim e ka përmendur si arsye këtë kriter qe nuk është plotësuar mirëpo si i tillë ky kriter i vlerësimit nuk gjendet as ne Njoftim për Kontratë dhe as ne dosje te tenderit per kete aktivitet prokurimit ,,prandaj ne ketë pike AK-nuk ka vepruar konform nenin 59 par.4 te LPP-se dhe piken 41. te RRUOPP-së(***Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve)***
Pretendimi ankimor qëndron për ketë pikë.

Përgjigjeje ne Pretendimi ankimor mbi listën e projekteve te ngjashme ne 3 vitet e fundit te natyrës se kontratës

*Nga lista e kontratave dhe referencave qe i ka dorëzuar OE-i rekomanduar për kontrate ,eksperti shqyrtues ka vërejtur se shumica janë te viteve 2014,2016 dhe vetëm dy kontrata te viteve 2017 edhe at kontrata me AK, Komunën e Fushë Kosovës me titull "**Renovimi ngjyrosja e objekteve shkollore**" ne vlere prej **25,966.70 €**, dhe kontrata tjetër me Komunën e Prishtinës me titull "**Riparimi i objekteve te bashkësive Lokale**" ne vlere prej **42,819.57 €**,pra edhe pse këto dy kontrata e plotësojnë kërkesën e 3 viteve te fundit nuk janë kontrata te njëjta sipas procedurave te kërkuar te AK-se.*
Kërkesa nga AK-ishte :"Lista me të cilën specifikohen të gjitha punët e projektet e realizuara të natyrës së kontratës në tri vitet e fundit duke ia bashkuar,referenca 45000 euro"
Pra lidhur me këtë pike pretendimi ankimor qëndron.

Përgjigjeje ne Pretendimi ankimor mbi listën e pagave se paku 5 punëtor

Lidhur me këtë nga administrimi i shkresave te ofertës se OE,se rekomduar për kontrate ka dorëzuar listën prej 5 punëtore,po ashtu OE,i rekomanduar ka dorëzuar listën nga ATK-ja prej 5 punëtoreve me kontribute te paguara për vitin 2020,për muajt Janar ,shkurt dhe për muajt Maj dhe Qershore.
OE,i shpallur fitues ka tjerë punëtore te deklaruar ne liste dhe tjerë punëtorë te deklaruar ne ATK-perveq inxhinierit te ndërtimtarisë Nuhi Nuhiu qe është ne te dy listat edhe te ATK-se edhe ne listën e kompanisë.
Saj përket pretendimit ankimore se OE.i rekomanduar për kontrate është dashur te deklaron liste prej 5 punëtoreve duke përjashtuar inxhinieret,ky pretendim qendron pjesërisht sepse AK-ne kriteret e përcaktuara ka theksuar : **Lista e stafit ku janë të përfshirë stafi i kërkuar në pikën 2 dhe më gjere,"***Ku ne piken 2 janë te përfshira inxhinieret dhe at një 1-Inxhinier i ndërtimtarisë,-drejtimi konstruktive ,një 1 Inxhinier i hidroteknikes, dhe një 1 ing.i gjeodezisë,pra me këtë sipas kërkesë se AK-se përfshihet lista prej 5 punëtoreve.*
Qe e ka te dorëzuar OE,i rekomanduar për kontrate ne listën e vete,
Prandaj pretendimi ankimore për këtë pikë është pjesërisht i bazuar sepse te gjithë inxhinieret nuk janë ne listën e ATK-se te deklaruar nga OE-i rekomanduar për kontratëë.

Përgjigjeje ne Pretendimi ankimor mbi ing.e gjeodezisë

Lidhur me këtë OE,i rekomanduar për kontrate ka dorëzuar listën e inxhiniereve ku përfshihet edhe ing.i gjeodezisë z,Fisnik Ismet Loshi,ku i njëjti është diplomuar ne gradën bachelor ne vitin 2007, duke marr titullin Bachelor i Fakultetit te Ndërtimtarisë Drejtimi Gjeodezi,i njëjti ka kryer disa kurse dhe ne vitin 2012 ka përfunduar një shkollim dy vjeçare ne një institut ne Suedi duke marr titullim Master i shkencave titull i cili i është njohur edhe nga Ministria e Arsimit,Shkencës dhe Teknologjisë,me gradë Master i Shkencave,i njëjti ne vitin 2018 ka marr licencën nga Agjencia Kadastrale e Kosovës duke u licencuar si gjeodet.
Pra pretendimi ankimor i OE,se ankues qëndron sepse kandidati i lartcekura nuk i ka 5 vite përvojë pune si inxhinier i gjeodezisë dhe nuk gjendet ne listën e punëtoreve te deklaruar ne ATK.

Përgjigjeje ne Pretendimi ankimor mbi ing.e kërkuar te jene ne listën e te punësuarve ose te ketë marrëveshje bashkëpunimi.

Lidhur me këtë OE.i rekomanduar për kontrate ka dorëzuar liste te punëtoreve duke përfshirë edhe inxhinieret e kërkuar mirëpo vetëm për Inxhinierin e ndërtimtari Drejtimi Konstruktive z.Nuhi Nuhiu ka deklaruar kontrate te punës,cv.dhe diplomën kurse për inxhinieret e tjerë (Gjeodezisë dhe Hidroteknikes) nuk ka te bashkangjitur CV.dhe as nuk janë ne listën e ATK-së
Prandaj ankesa për këtë pike është pjesërisht e bazuar.

Përgjigjeje ne Pretendimi ankimor për makinë saldimi,

Nga shkresat e lendes eksperti shqyrtues ka vërejtur se OE,i rekomanduar për kontrate ka marrëveshje edhe at me OE,Hidroprojekt, marrëveshje për shfrytëzimin e makinës për saldim,kjo e dëshmuar edhe me Dokumentin Unik Doganor DUD.OE,i Rekomanduar gjithashtu ka prezantuar certifikata për saldim për dy punëtore nga marrëveshja e bashkëpunimit me OE,Hidroprojkt dhe at për punëtoret Valentin Morina dhe Xhylazim Gashi,mirëpo këto certifikata janë ne gjuhen gjermane jo ne gjuhen zyrtare ne Kosovës e kjo bie ndesh me nenin 13 paragrafi 4 i LPP-se qe thotë **"Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze."**

Prandaj pretendimi ankimor është i bazuar.

Nga sa u tha me lart dhe nga ajo qe është pare ne shkresat e lendes Zyrtari përgjegjësi i prokurimit te AK-se nuk ka vepruar konform nenit 112 te LPP-se qe ne momentin e dorëzimit te kërkesës për rishqyrtim në AK apo një ankese ne OSHP-Aktiviteti i prokurimit te pezullohet,
Nga ajo qe është pare ne platformën e prokurimit elektronik te këtij aktiviteti nuk ka te ngarkuar ndonjë dokument për pezullim te këtij aktiviteti.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura (përgjigjet e dhëna me larte), eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues te OSHP-së qe ankesa te pranohet si e bazuar dhe Vendimi i AK-së të anulohet.

Raporti i ekspertizës t'i dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KRU."HIDROMORAVA"SH.A.**
- Panelit Shqyrtues –**OSHP-së**
- OE ankues **-OE. "K.N.T.SH."TEUTA-M"SH.P.K**